



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 12449/7705/2932 (31104-01692-86-2016)  
Data e regjistrimit 15.04.2016

Nr. Vendimit 82  
Data e vendimit 19.01.2018

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ  
Bari SHYTI  
Amarildo LAÇI

KRYESUESE  
ANËTAR  
ANËTAR

me sekretare gjyqësore [redacted] në Tiranë, sot më datë 19.01.2018, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

**PADITËS:** *Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier.*

**E PADITUR:** *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

**PERSONI I TRETË:** [redacted] e bija e [redacted] dhe e [redacted] e datëlindjes [redacted], lindur në [redacted] e banuese në [redacted]

**OBJEKTI:**

- 1) Shfuqizimin e vendimit administrativ nr. 128, datë 08.09.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 2) Pezullimin e zbatimit të këtij vendimi deri në përfundim të gjykimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32, 153, 154, 324, 325, 331 të K.P.Civile; nenet 108, 109, 137 e vijues të K.Pr.Administrative; Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe

*gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet  
14, 15, 16, 17, 18/1 e vijues*

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, dhe bisedoi çështjen në tërësi:

#### **VËREN**

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 15.04.2016 janë regjistruar ankimet e paraqitura nga pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe personi i tretë Tushe Qalliu, kundër vendimit nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenet 442, 443 të Kodit të Proçedurës Civile dhe nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*. Këto ankime janë paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 31.12.2015 dhe në datën 03.02.2016. Kjo gjykatë me vendimet e datës 31.12.2015 dhe 03.02.2016, ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur dhe personit të tretë, duke i dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit së bashku me aktet e njoftimit të tyre si dhe dosjen e gjykimit për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 09.10.2015, pala paditëse, DRSSH Fier, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë, pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015 ka vendosur: *“Pranimin e padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier. Shfuqizimin e vendimit nr. 128, datë 08.09.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i detyrueshëm i tij bëhet nga përmbaruesi gjyqësor. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës së paditur. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. Për palën e paditur në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimi”*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Rezultatet e proçesit të hetimit, pretendimet e palëve dhe provat për mbrojtjen e këtyre pretendimeve, krijojnë bindjen e mjaftueshme se ankuesja [REDAKTUAR] është vendosur përballë një situatë diskriminuese, me pasojë bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive të saj.
- ✓ Deklarimet e bëra gjatë seancës dëgjimore, në veçanti deklarimi i bërë nga z. [REDAKTUAR] Drejtori i DRSSH Fier, se “Po ta kisha mjeke të KMCAp-së do ta kisha hequr

që në momentin e parë që kam ardhur në punë, pasi nuk do të kisha besim, si rezultat i atyre pamjeve filmike që janë transmetuar”, janë deklarime që çenojnë rëndë integritetin e personit, për më tepër që paditësi, z. [REDAKTUAR], në cilësinë e drejtorit të institucionit, mbrojtës dhe zbatues i ligjit, me këto deklarime del mbi gjykatën dhe konteston hapur vendimin e saj, ndërkohë që nëpunësja e tij znj. [REDAKTUAR] ka marrë pafajësinë dhe është kthyer në vendin e mëparshëm të punës.

- ✓ Edhe gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore, z. [REDAKTUAR] ka vazhduar të pohojë të njëjtin deklaram që ka bërë gjatë seancës dëgjimore në KMD dhe ky është një fakt i pamohueshëm, që është anashkaluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe figuron si provë e regjistruar në audio, gjatë seancave gjyqësore.
- ✓ Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nuk ka marrë në konsideratë dëshmitë dhe shpjegimet që pala e paditur KMD dhe personi i tretë i thirrur nga gjykata, znj. Tushe Qalliu, kanë dhënë gjatë tri seancave gjyqësore të regjistruara në audio.
- ✓ Ky pretendim është i bazuar në një provë, shkresa nr. 928/1 prot, datë 25.03.2015 e DRSSH-Fier, formular i dyfishtë për pëfitimin e pagesës së papunësisë, referuar VKM nr. 223, datë 19.04.2006 “Për pagesën e së ardhurës së papunësisë”.
- ✓ Ky formular është detyrim i titullarit të institucionit t’ia japi të plotësuar çdo subjekti kërkues, detyrim i cili nuk është zbatuar nga paditësi, DRSSH-Fier.
- ✓ Paditësi nuk ka pranuar ta firmosë formularin, cfarë i ka kushtuar ankueses Tushe Qalliu, mosmarrjen e pagesës së papunësisë. Në këtë kontekst jemi përballë faktit, kur ankuesia është përjashtuar nga ushtrimi i të drejtës së saj të ligjshme, duke iu mohuar ushtrimi i kësaj të drejte. Është qartësisht e dukshme se trajtimi që i padituri, Drejtori i DRSSH Fier, z. [REDAKTUAR] i ka bërë vartëses së vet, ankueses [REDAKTUAR] është diskriminues.
- ✓ Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë nuk ka cituar asgjë lidhur me seancat gjyqësore, shpjegimet që palët kanë dhënë për çështjen objekt gjykimi, pyetjet që i ka drejtuar palëve, mbrojtjen që palët i kanë bërë pretendimeve të tyre, debatin mes tyre dhe pyetjet që palët i kanë drejtuar njëra-tjetrës.
- ✓ Po ashtu, Gjykata nuk ka reflektuar asgjë lidhur me shpjegimet dhe pretendimet që ankuesja znj. [REDAKTUAR] ka dhënë në seancën e veçantë gjyqësore, ndërsa është thirrur prej saj, në cilësinë e personit të tretë, që ka interes të drejtpërdrejtë në çështje, seancë gjithashtu e regjistruar në audio.

***Për sa më sipër pala e paditur Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.***

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim personi i tretë [REDAKTUAR] duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Këtë vendim gjykata e ka dhënë në kundërshtim me provat e administruara në gjykim dhe konkretisht me procesverbalin e ballafaqimit të datës 20.04.2015 të bërë nga Komisioneri midis meje dhe paditësit.
- ✓ Siç ka deklaruar edhe vetë drejtori aktual, më ka paragjykuar për vendimin penal të pafajësisë sime duke më thënë “e di mirë unë se si e ke fituar ti atë pafajësi”.
- ✓ Vendimi i Komisionerit është i bazuar dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Drejtori i DRSSH Fier më ka larguar nga puna më motivacionin se kam kryer sipas tij shkelje të rënda dhe për shkak të vonesave në pagesë të qytetarëve dhe se ka ankesa të shumta nga qytetarët dhe mjekët e qendrave shëndetësore dhe se kam abuzuar me firmën e drejtorit në disa praktika duke shkelur mirëbesimin. Këto motive të largimit janë të padrejta dhe të pabazuara, pasi drejtori e ka paragjykuar pozicionin tim në punë, më ka diskriminuar ndryshe nga punonjësit e tjerë dhe më ka thënë se: “do të të qëroj nga puna pavarësisht se ke marrë një vendim pafajësie”.
- ✓ Për shkak të pretendimeve për diskriminim i jam drejtuar KMD dhe kam paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Edhe në mbledhjen e datës 20.04.2015 drejtori ka deklaruar se: “po ta kisha mjeke të KMCAP do ta kisha hequr që në momentin e parë që kisha ardhur, pasi nuk do të kisha besim si rezultat i atyre pamjeve filmike që janë transmetuar”.
- ✓ Siç ka deklaruar vetë drejtori ai më ka paragjykuar duke më thënë se “e di unë si e ke fituar ti atë pafajësi”. Në kohën që unë kam qënë në ndjekje penale, ai nuk ka qënë drejtor dhe nuk ka pasur mundësi t’i shohë pamjet filmike. Kam qënë e përndjekur vazhdimisht nga ky drejtor për shkak të procedimit penal pasi dhe kur i kërkova një të drejtë ligjore për të përfituar pagesë papunësie pas largimit nga puna, më ka nxjerrë vazhdimisht pengesa duke më thënë se “ke lekë plot dhe ke mbledhur lekët me tepsi”.
- ✓ Edhe kur u detyrova të marr avokat, pasi drejtori nuk i protokollonte kërkesat e mia për plotësimin e formularit të dyfishtë sipas VKM nr. 223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurave nga papunësia”, përsëri drejtori nuk ka paraqitur arsye pse nuk e lëshonte formularin e dyfishtë që unë të përfitoja pagesën e papunësisë. Edhe vetë drejtori i Zyrës së Punësimit ka komunikuar me telefon me drejtorin dhe ai përsëri nuk ma ka dhënë këtë formular dhe i gjithë inati kishte lidhje me vendimin penal.

***Për sa më sipër personi i tretë [REDAKTUAR] ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.***

#### ***Rrethanat faktike të çështjes***

Shtetasja [REDAKTUAR] person i tretë në këtë gjykim, ka qënë punonjëse pranë DRSSH Fier në detyrën “mjeke specialiste në sektorin e përfitimeve afatshkurtra” për periudhën 23.06.2000 deri 30.07.2010. Në datën 30.07.2010, ajo është pezulluar nga detyra për shkak të fillimit të një

proçedimi penal në ngarkim të saj dhe personave të tjerë me akuzën e korrupsionit pasiv të kryer në bashkëpunim, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Pezullimi është kryer në bazë të Rregullores nr. 2, datë 26.2.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Kreu IV, pika 2, “Pezullim nga puna”. Pas përfundimit të proçesit gjyqësor, i cili e shpalli shtetasen Tushe Qalliu të pafajshme, ajo është kthyer në detyrën e mëparshme, përkatësisht në datën 05.12.2012, ku ka vazhduar të punojë deri me datën 05.01.2015, kohë kur i janë ndërprerë edhe marrëdhëniet e punës me DRSSH Fier.

Ndaj zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, kjo shtetase i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin nr. 640, datë 11.05.2015 ka vendosur: *“Pranimin e pjeshëm të kërkesë-padisë. Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditëses Tushe Qalliu një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për shkak të mosrespektimit të proçedurës së kontratës së punës. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Shërbimi Përmbartimor. Ky vendim duhet të ekzekutohet brenda një afati 3 mujor nga dita që vendimi merr formë të prerë dhe me një kësht”* Rezulton se objekti i gjykimit në çështjen e mësipërme ka qenë: *“Kërkim dy paga dëmshpërblim për mosrespektim të proçedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Kërkim 7 paga dëmshpërblim për vjetërsinë në punë. Kërkim 12 paga dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës”*

Krahas paraqitjes së padisë në fjalë, personi i tretë [REDAKTUAR] ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, regjistruar me nr. 8 regjistri datë 02.02.2015. Në ankesë, kjo shtetase ka parashtruar se ka pretendime të natyrës diskriminuuese në lidhje me veprimtarinë e DRSSH Fier, ku me cilësinë e titullarit është shtetasi [REDAKTUAR] Shkaku i përzgjedhur i diskriminimit në tabelën e formularit përkatës së ankesës, është “Çdo shkak tjetër” (numri 26 i formularit për shkaqet e diskriminimit). Ankimit i bashkëngjitet ankesa kundër vendimit të drejtorit të DRSSH Fier. Po sipas ankesës, masa që kërkohet të merret nga KMD është: “Rikthim në vendin e punës pasi jam larguar me pa të drejtë dhe të më hiqet masa disiplinore”. Koha kur pretendohet të ketë ndodhur diskriminimi dhe ankuesja të ketë marrë dijeni për të, është shtator 2014.

Në datën 03.02.2015 pranë KMD është zhvilluar një takim midis personit të tretë [REDAKTUAR] dhe inspektorese së KMD-së pranë Drejtorisë së Hetim Inspektimit. Ky takim është dokumentuar me proçesverbalin e datës 03.02.2015 të KMD-së, në të cilin janë marrë shpjegime në lidhje me pretendimet e personit të tretë në gjykim, [REDAKTUAR] E pyetur në lidhje me saktësimin e shkakut të diskriminimit në proçesverbal, shënohet se kjo shtetase nuk është në gjendje të identifikojë një shkak konkret “por mendonte se humbja e besimit që drejtori kishte ndaj saj si punonjëse, është shkak i diskriminimit të saj”. Sipas saj asnjë nga shkaqet e cituara në vendimin e largimit nga puna nuk është i justifikuar ligjërisht dhe se ka dërguar edhe observacionet në lidhje me këtë vendim, por ato nuk janë marrë në konsideratë. Ajo ka pretenduar se ndaj saj nuk

është marrë asnjë masë disiplinore tjetër paraprakisht, por është marrë direkt masa ekstreme e largimit nga puna.

Me shkresën nr. 129/1 prot., datë 09.02.2015 "Njoftim dhe kërkesë për informacion", KMD i është drejtuar DRSSH Fier, me të cilën e vë në dijeni të ankimit të paraqitur nga shtetasja [REDAKTUAR] dhe kërkohet informacion i hollësishëm mbi çështjen. Kërkesa i referohet parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenit 32, pika 1, shkronja "c". Me shkresën nr. 129/4 prot., datë 27.03.2015, KMD i drejtohet DRSSH Fier me lëndë: "Dërgohet Urdhri nr. 36, datë 27.03.2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e Znj. [REDAKTUAR]. Bashkëlidhur shkresës, ndodhet Urdhri nr. 36, datë 27.03.2015 i Komisionerit, me të cilin urdhërohet kryerja e inspektimit nga dy inspektorë të KMD-së, pranë DRSSH Fier me datën 02.04.2015, Qëllimi i inspektimit është verifikimi i pretendimeve për diskriminim nga shtetasja [REDAKTUAR]. Objekti i inspektimit është përshkruar hollësisht në pikën 4 të urdhrin dhe konkretisht:

- Kryerja e verifikimeve mbi ankesat e qytetarëve, që janë dërguar kundër znj. [REDAKTUAR] pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.
- Kryerja e verifikimeve mbi ankesat e mjekëve të Qendrave Shëndetësore, që janë dërguar kundër Znj. [REDAKTUAR], pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier.
- Verifikimi i rasteve konkrete, ku kontrollet e ushtruara nga mjekja [REDAKTUAR] pranë Qendrave Shëndetësore, kanë dalë jashtë kompetencave të saj.
- Informacion mbi faktin, nëse ndaj ankueses është marrë paraprakisht ndonjë masë tjetër disiplinore.
- Verifikimi i rasteve konkrete, ku Znj. [REDAKTUAR] ka abuzuar me firmën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen e Znj. [REDAKTUAR]

Me shkresën nr. 300/1 prot. datë 31.03.2015, KMD i drejtohet DRSSH Fier me lëndë: "Dërgohet Urdhri nr. 37, datë 31.03.2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Fier, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e znj. [REDAKTUAR]. Bashkëlidhur shkresës, ndodhet Urdhri i dytë me nr. 37, datë 31.03.2015 i Komisionerit, sipas të cilit urdhërohet kryerja e inspektimit nga dy inspektorë të KMD-së të kryejnë inspektim pranë DRSSH Fier me datën 02.04.2015. Qëllimi dhe objekti i inspektimit është i njëjtë me urdhrin e parë, përshkruar hollësisht në pikën 4 të urdhrin (të njëjtat detyra si në urdhrin nr. 36).

Në datën 08.04.2015 pranë DRSSH Fier, është mbajtur një procesverbal "Inspektimi administrativ" në prezencë të Inspektorëve të KMD-së të caktuar me urdhrin e lartpërmendur si dhe disa përfaqësuesve të DRSSH Fier, Kryetari i Degës së Përfitimeve, një specialiste e kësaj Dege, si dhe Kryetari i Degës së Administrimit, në të cilin janë shënuar verifikimet e kryera dhe deklaratimet e punonjësve të DRSSH Fier në lidhje me ankimin e personit të tretë në gjykim [REDAKTUAR]

si dhe procedurat e ndjekura në rastin e largimit të saj nga puna. Në këtë procesverbal rezulton të jetë shënuar edhe pretendimi i drejtorit të DRSSH Fier se: *“Nuk mendoj që kam kryer veprime diskriminimi ndaj znj. Jam treguar i hapur ndaj kësaj punonjëseje dhe i kam respektuar çdo të drejtë ligjore”*. Kryetari i Degës së Administrimit, ndër të tjera mbi pyetjet e bëra ka dhënë këtë informacione: *Shtetasja nuk kishte marrë masa të mëparshme disiplinore para largimit nga puna. Nuk disponohen ankesa me shkrim apo nuk ka në administrim ankesa të protokolluara të qytetarëve ndaj znj. por se janë paraqitur pranë tij ankesa të drejtpërdrejta të qytetarëve (jo zyrtare) ushtu si edhe ankesat e mjekëve të Qendrave Shëndetësore ndaj saj. Lidhur me mosplotësimin e formularit të dyfishtë për përfitim të paditëses nga Zyra e Punës, asaj i është dërguar përgjigje zyrtare dhe se formulari duhej të plotësohej nga Zyra e Punës për tu plotësuar nga DRSSH Fier. Kryetaria e Degës së Përfitimeve ndër të tjera mbi pyetjet e bëra ka deklaruar se: *Asnjë ankesë nuk është depozituar pranë saj, por se znj. ka patur konflikte të drejtpërdrejta me qytetarët në ambientet e DRSSH Fier. Planet e punës së znj. janë dorëzuar dhe firmosur prej saj, por ndonjëherë kanë qenë edhe jashtë afatit. Shtetasja T. nuk kishte marrë masa të mëparshme disiplinore para largimit nga puna. Kryetarja e Degës së Përfitimeve dhe specialistja e pranishme e Degës së Degës së Përfitimeve, kanë deklaruar se znj. ka zvarritur afërsisht 30 praktika, duke shkaktuar edhe vonesa në pagesën e qytetarëve, pasi nënshkrimi i saj si mjeke kërkohej në kartelën financiare të individit që paraqet kërkesë për përfitim. Kryetari i Degës së Administrimit dhe Kryetarja e Degës së Përfitimeve kanë theksuar faktin se znj. ndërhynte në kompetencat e tyre lidhur me çështje financiare, ndërsa duhej të merrej vetëm me çështje mjekësore dhe sipas Kryetares së Degës së Përfitimeve, znj. ka refuzuar të firmosë rreth 30 praktika, ndërsa janë zvarritur rreth 60 praktika.**

Me shkresën nr. 300/2 prot. datë 14.04.2015 “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, njoftohet shtetasi, në cilësinë e drejtorit të DRSSH Fier dhe shtetasja Ky takim është dokumentuar me procesverbalin e takimit të datës 20.04.2015 të KMD-së, në të cilin janë marrë shpjegime në lidhje me pretendimet e personit të tretë në gjykim. Në takim palët kanë mbajtur qëndrimin e tyre në lidhje me pretendimet përkatëse. Vlen të theksohet se në procesverbal është shënuar një deklaram i drejtorit të DRSSH Fier me këtë citim: *“Po ta kisha mjeke të KMCAP do ta kisha hequr që në momentin e parë që kam ardhur në punë, pasi nuk do të kisha besim si pasojë e atyre pamjeve filmike që janë transmetuar”*. Në lidhje me këtë deklaram dhe mënyrën se si është mbajtur procesverbali në tërësi, Drejtori i DRSSH Fier e ka kundërshtuar atë, dhe ka shënuar në fund observacionin e tij se: *“Nuk jam dakord me përmbajtjen e procesverbalit pasi nuk janë përfshirë deklaramet e dhëna prej meje. Në disa raste në fletën e parë deklaramet janë deformuar dhe në raste të tjera nuk janë përfshirë, ndërkohë që deklaramet e palës tjetër janë përfshirë të gjitha me imtësi. Shoh dhe konstatoj që ky procesverbal është i parregullt për sa i përket deklarameve të mia”*. Sipas deklarameve të palëve në gjykim, u pranua se koha e plotë e shpenzuar për marrjen në pyetje të subjekteve reflektuar në procesverbal ka qenë mbi tre orë, dhe

në kushtet e kundërshtimit të përmbajtjes së procesverbalit, përfaqësuesit e pranishëm të KMD-së kanë ofruar mundësinë e ripërpilimit nga e para, por se kjo nuk ka ndodhur, pasi Drejtori i DRSSH është larguar.

Në vijim, me vendimin nr. 128, datë 08.09.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të znj. [REDAKTUAR] nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, për shkak se ankuesja ka qenë e ndjekur penalisht në të kaluarën.
2. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme nga ana e DRSSH Fier, për rikthimin në punë të znj. [REDAKTUAR]
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DRSSH Fier të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas pikës 13, të po këtij neni.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i është dërguar me shkresën nr. 372/2 prot., datë 08.09.2015 të KMD-së, shtetasit [REDAKTUAR] në cilësinë e drejtorit të DRSSH-së, si dhe shtetases [REDAKTUAR]. Pas marrjes dijeni të këtij vendimi dhe duke mos qenë dakort me të, pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë objekt gjykimi duke kërkuar sipas objektit të padisë.

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në aktin e ankesës të datës 02.02.2015 pranë KMD e cila ka iniciuar këtë procedim, shtetasja [REDAKTUAR] nuk ka identifikuar shkakun konkret për të cilën ajo ka paraqitur ankesën, ndërsa ka kërkuar nga KMD "Rikthim në vendin e punës pasi jam larguar me pa të drejtë dhe të më hiqet masa disiplinore". Në procesverbalin e parë të mbajtur nga KMD në datë 03.02.2015, është raportuar se vetë ankuesja nuk është në gjendje të identifikojë një shkak konkret, "por mendonte se humbja e besimit që drejtori kishte ndaj saj si punonjëse, është shkak i diskriminimit të saj". Në parashtrimet gjyqësore, ankuesja e thirrur si person i tretë referoi tek deklarata konkrete të adresuara ndaj saj nga Drejtori i DRSSH, madje edhe përpara kohës së emërimit të tij në këtë detyrë, fakt i cili nuk gjen përjasje me vështirësinë e identifikimit të shkakut diskriminues në datë 03.02.2015, kohë kur ajo ishte larguar nga puna.

Nga procesverbali i inspektimit administrativ, mbajtur në ambientet e DRSSH Fier në datë 08.04.2015 mbi deklaratimet e Kryetares së Degës së Përfitimeve, një specialisteje të kësaj Dege, si dhe Kryetarit të Degës së Administrimit, ka rezultuar e pohuar prej tyre se, ndërsa znj. Qalliu nuk kishte marrë asnjë masë të mëparshme disiplinore para largimit nga puna, ndaj saj janë paraqitur ankesa të drejtpërdrejta të qytetarëve (jo të protokolluara) ashtu si edhe ankesat e



mjekëve të Qendrave Shëndetësore; ankuesja ka patur konflikte të drejtpërdrejta me qytetarët në ambientet e DRSSH Fier; planet e punës të znj. [REDAKTUAR] janë dorëzuar dhe firmosur prej saj, por ndonjëherë kanë qenë edhe jashtë afatit; ndërhynte në kompetencat e eprorëve lidhur me çështje financiare, ndërsa duhej të merrej vetëm me çështje mjekësore dhe sipas Kryetares së Degës së Përfitimeve, znj. [REDAKTUAR] ka refuzuar të firmosë rreth 30 praktika, ndërsa janë zvarritur rreth 60 praktika duke krijuar zvarritje në pagesat e përfituesve. Këto informacione të cilat kanë qenë objekt vlerësimi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe lidhen me pretendimet mbi shkelje të detyrimeve kontraktuale, nuk mund të shërbejnë si indicie e besueshme për ekzistencën e një shkakut diskriminues, kur në asnjë deklaram të kësaj date nuk jepet një informacion i tillë.

Me procesverbalin e takimit të datës 20.04.2015 të KMD-së, janë marrë shpjegime nga personi i tretë në gjykim, [REDAKTUAR], dhe Drejtori i DRSSH-Fier, [REDAKTUAR]. Ky i fundit kontestoi mënyrën e mbajtjes së procesverbalit nga inspektorët, veçanërisht deklarimin e tij të përshkruar në faqen nr. 4.4 të procesverbalit, ku thuhet se: *“Po ta kisha mjeke të KMCAP do ta kisha hequr që në momentin e parë që kam ardhur në punë, pasi nuk do të kisha besim si pasojë e atyre pamjeve filmike që janë transmetuar”*. Ky deklaram është ndërprerë nga shënime të shuajtura prej inspektorit që e ka mbajtur aktin dhe është kundërshtuar nga deklaruesi [REDAKTUAR] i cili ka nënshkruar nën kundërshtimin e bërë prej tij. Në tërësi të procesverbalit nuk ka asnjë deklaram tjetër të z. [REDAKTUAR] lidhur me shkakun e pretenduar të diskriminimit të znj. [REDAKTUAR], ndërsa është diskutuar mbi problemet e evidentuara të punës që kanë çuar sipas Drejtorit të DRSSH Fier në largimin e saj nga puna. Sipas deklarimeve të ankueses të pasqyruara në procesverbal, mosdhënia e përgjigjeve nga Drejtori mbi problemet e punës së shtrua prej saj ka të bëjë me veprime diskriminuese.

Sipas deklarimeve të palëve në gjykim, u pranua se koha e plotë e shpenzuar për marrjen në pyetje të subjekteve reflektuar në procesverbalin e datës 20.04.2015 ka qenë mbi tre orë, dhe në kushtet e kundërshtimit të përmbajtjes së procesverbalit, përfaqësuesit e pranishëm të KMD-së kanë ofruar mundësinë e ripërpilimit nga e para, por se kjo nuk ka ndodhur, pasi Drejtori i DRSSH është larguar në mënyrë demonstrative, situatë e cila nuk ishte hasur më parë në praktikën e tyre të punës. Ky i fundit pretendoi se ka qenë tërësisht i frustruar nga mënyra sesi është komunikuar nga inspektorët, të cilët sipas tij, kanë demonstruar qëndrim të njëanshëm ndaj ankueses. Gjykata vëren se procesverbali i kontestuar nga subjekti deklarues [REDAKTUAR], në pjesën ku bën fjalë për deklarimin e sipërcituar, është ndërprerë nga disa fjalë të cilat janë shuar nga inspektori që e ka mbajtur, dhe nuk mund të konsiderohet i saktë mbi mënyrën e pasqyrimin të pretendimeve. Gjykata ka kërkuar informacion nëse seanca dëgjimore ishte e regjistruar me sistem audio dhe u konfirmua nga përfaqësuesja që ishte mbajtur vetëm me shkrim. Fakti që kundërshtimet janë pasqyruar aty për aty, shënuar në procesverbal dhe fakti që përfaqësuesja relatoi tek mundësia që iu dha palës paditëse për rimbajtjen e tij, e bëjnë të cënueshme saktësinë e deklarimeve në këtë procesverbal.

Gjykata vëren se në asnjë prej akteve të tjera të mbajtura gjatë hetimit administrativ nga inspektorët e KMD-së, nuk ka rezultuar i provuar qartë shkak diskriminues ndaj shtetases [REDAKTUAR] për largim nga detyra, për shkak se ka qenë e proceduar më parë penalisht. Pretendimet e shtetases [REDAKTUAR] të bëra para gjykatës, janë deklarata të saj si ankuese, dhe si të tilla nuk mjaftojnë për të provuar vërtetësinë e pretendimit. Rezulton që paditësja nuk ka pretenduar të njëjtin shkak abuziv për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 146 të Kodit të Punës përpara gjykatës administrative të shkallës së parë Vlorë, kur ligji ia njuh këtë mundësi. Ndaj objektit të padisë, ku ndër të tjera është kërkuar edhe dëmshpërblimi prej 12 muaj pagë për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, kjo gjykatë me vendimin nr. 640, datë 11.05.2015, i ka njohur shtetases [REDAKTUAR] vetëm një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës së kontratës së punës, ndërsa ka konsideruar të justifikuar zgjidhjen e kontratës nga punëdhënësi, për shkelje të rënda të detyrimeve kontraktore. Në asnjë nga deklaratat e marra nga punonjësit e DRSSH Fier dhe në asnjë nga dokumentet e verifikuara dhe të administruara nga inspektorët e KMD-së, nuk ka asnjë prononcim nga të tretë që të referojnë se shkak për largimin nga detyra të shtetases [REDAKTUAR], të ketë qënë procedimi penal i saj në të kaluarën.

Gjykata vëren se humbja e besimit nga titullari i subjektit punëdhënës për vazhdimin e marrëdhënies së punës nga punëmarrësi dhe diskriminimi i punëmarrësit në raportet e punës sipas ligjit nr. 10221/2010, janë dy situata të ndryshme ligjore. Vetëm fakti i largimit nga puna nuk mjafton që të konkludohet se kemi të bëjmë me diskriminim, aq me tepër kur DRSSH Fier mban qëndrimin se punonjësj [REDAKTUAR] ka shkelur detyrimet kontraktuale nëpërmjet disa veprimeve të evidentuara ndaj saj, sqaruar në ecuri të këtij gjykimi dhe më lart në vendim. Gjykata vëren gjithashtu se në raportin kohor midis fillimit të ndjekjes penale dhe deklarimit të pafajshëm me vendim të formës së prerë të znj. Qalliu dhe kohës së zgjidhjes së kontratës së punës ndaj saj nga DRSSH Fier ka kaluar një kohë e konsiderueshme. Konkretisht, vendimi i gjykatës së Apelit Vlorë është i datës 08.06.2012, dhe paditësja është kthyer në punë në datë 05.12.2012. Zgjidhja e kontratës është bërë në Janar të vitit 2015.

Lidhur me pretendimin se nga ana e Drejtorit të DRSSH nuk i është plotësuar znj. [REDAKTUAR] formulari i dyfishtë me qëllim përfitimin financiar sipas parashikimit me aktin specifik nënligjor pranë Zyrës së Punës, u paraqit në gjykim me cilësinë e provës shkresa nr. 928/1 prot. datë 25.03.2015 e DRSSH Fier "Kthim përgjigje", drejtuar avokates së znj. [REDAKTUAR] dhe vetë asaj në lidhje me dokumentacionin për formularin e dyfishtë dhe listës së notave, në lidhje me problematikën e përfitimit të pagesës së papunësisë, referuar VKM nr. 223, datë 19.04.2006 "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia". Në këtë shkresë, palës paditëse i është kërkuar të paraqesë një kopje të kërkesës së bërë pranë Zyrës së Punës me qëllim plotësimin e formularit. Pretendimet e ankueses për vonesa në marrjen e dokumentit, nuk barazvlefësohen me të provuarit e diskriminimit të saj për shkak të procedimit penal. Nga sa më sipër, gjykata arrin në

përfundimin se vendimi i nxjerrë nga KMD me nr. 128, datë 08.09.2015, nuk ka mbështetje në prova mbi shkakun e konstatuar të diskriminimit ndaj padia duhet të pranohet duke vendosur gjykata shfuqizimin e aktit administrativ.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, të evidentuara gjatë gjykimit, ato janë në ngarkim të palës së paditur sipas nenit 106 të Kodit të Proçedurës Civile, dhe përbëhen nga tarifa për ngritjen e padisë + njoftime, në vlerën 3.200 lekë sipas mandatit të pagesës datë 09.10.2015.

### ***Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit***

***Së pari*** Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimeve objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7, germa "a", nenit 10, paragrafi 2, germa "a" dhe nenit 44 të ligjit nr. 49/2012, kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

***Së dyti*** Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimeve. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 17.12.2015, në mungesë të palës së paditur të cilës i është komunikuar vendimi në datën 21.01.2016. Ankimi nga pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur në datën 03.02.2016 dhe nga personi i tretë [REDAKTUAR] është paraqitur në datën 31.12.2015. Pra të dyja ankimet janë paraqitur brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, të përcaktuar në nenet 443, paragrafi i parë dhe 444, paragrafi i parë të Kodit të Proçedurës Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimet rezultojnë të jenë të plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat ato janë paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimet e paraqitur kundër vendimit nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë objekt gjykimi, duhet të pranohen për shqyrtim.

***Së treti*** Në analizë të pretendimeve të parashtruara në ankim nga pala e paditur dhe personi i tretë, të rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe vendimi duhet të lihet në fuqi. Konstatohet se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim u është dhënë zgjidhje me vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezulton të jetë plotësisht e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të ligjit specifik lidhur me shfuqizimin e aktit administrativ të kundërshtuar nga pala paditëse.

Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzionin se kërkesëpadia e paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier është e bazuar dhe ka disponuar me pranimin e saj. Për të arritur në këtë konkluzion Gjykata fillimisht vlerëson të marrë në analizë kuadrin ligjor mbi të cilin është bazuar veprimtaria administrative e palës së paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, objekt kundërshtimi me padinë në gjykim, konkretisht parashikimet e ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Duke patur parasysh se vendimarrja e palës së paditur është e lidhur me diskriminimin në punësim, fillimisht gjykata referohet në parashikimet specifike të ligjit lidhur me ndalimin e diskriminimit në punësim. Konkretisht neni 12 i ligjit në paragrafin 1 parashikon se: "*1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.*" Kurse neni 1 i ligjit parashikon se: "*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*"

Pra, ligji e përkufizon diskriminimin si bërje e dallimit të paarsyeshëm ligjor ose faktik, ose si veprim apo mosveprim të pabarabartë përsa i përket personit ose grupit të personave që mbështetet mbi gjininë, racën, ngjyrën e lëkurës, seksin, përkatësinë etnike, mbi gjuhën, shtetësinë, mbi origjinën sociale, mbi bësimin fetar, mbi arsimin, mbi përkatësinë politike, mbi statusin personal ose shoqëror, mbi pengesat mendore dhe trupore, mbi moshën, gjendjen familjare, mbi statusin pronësor, mbi gjendjen shëndetësore, dhe mbi çdo bazë tjetër e cila është e parashikuar me Kushtetutë, marrveshje ndërkombëtare apo me ligj. Një përcaktim i tillë është theksuar edhe në nenin 3 të ligjit i cili në mënyrë të shprehur parashikon se: "*1. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*" Sjellja dhe trajtimi diskriminues është çdo sjellje aktive ose passive ndaj çdo personi nga ana e pushtetit si dhe nga ana e personave fizikë e juridikë të sektorit privat dhe public, që krijon baza për privilegimin ose mosprivilegimin e ndonjë personi në mënyrë të paarsyeshme ose kur e ekspozon në sjellje të padrejtë degraduese në krahasim me persona të tjerë në situatë të ngjashme që mbështetet mbi çdo bazë diskriminuese.

Mbi arsyetimin e mësipërm, në rastin në gjykim, Gjykata përqëndrohet në provueshmërinë e faktit nëse personi i tretë [REDAKTUAR] është ndjerë e dalluar faktikisht dhe cilat janë veprimet apo mosveprimet që kanë sjellë si pasojë këtë dallim të pabarabartë të saj. Rezulton se pretendimet e kësaj shtetaseje, të vlerësuara edhe nga pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë të lidhura me diskriminimin nga punëdhënësi i saj për shkak të faktit se disa vite më parë kjo shtetase është ndjekur penalisht për vepra penale të lidhura me detyrën dhe për të cilat ajo është shpallur e pafajshme me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se pretendimet e kësaj shtetasje rezultojnë të pabazuara në asnjë prej provave të tjera, për më tepër edhe vetë fakti që personi i tretë rezulton të jetë larguar nga puna për motive që nuk janë të lidhura me ndjekjen penale të saj. Nëse shkaqet për të cilat ajo është larguar nga puna janë apo jo të justifikuar, kjo mbetet në vlerësim të gjykatës që shqyrton mosmarrveshjen e punës midis palëve, mbi bazën e padisë së paraqitur nga shtetasja [REDAKTUAR]. Pikërisht këtu qëndron edhe ndryshimi midis veprimeve apo mosveprimeve diskriminuese ndaj punëmarrësit dhe shkaqeve të pajustificuara të largimit të punëmarrësit nga puna. Në rastin e parë merren në shqyrtim veprime ose mosveprime të cilat pavarësisht faktit se mund të jetë të ligjshme ose jo, vendosin punëmarrësin në pozitë të pabarabartë me punojësit e tjerë në mënyrë të paarsyeshme, kurse në rastin e dytë, gjykata shqyrton ligjshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës midis palëve, duke vlerësuar në themel ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e shkaqeve të zgjidhjes së kësaj kontrate.

Për sa më sipër, konkludohet se në të kundërt nga sa është pretenduar nga pala e paditur, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe personi i tretë [REDAKTUAR] në ankimet e paraqitura, vendimarrja e palës së paditur, objekt kundërshtimi, vjen në kundërshtim me ligjin pasi nuk është bërë e mundur provueshmëria e veprimeve apo mosveprimeve konkrete të palës së paditur që të ketë sjellë si pasojë trajtimin e pabarabartë të shtetasës [REDAKTUAR] në raport me persona të tjerë. Për këtë arsye, kjo Gjykatë çmon se, në përputhje me disponimin e gjykatës së shkallës së parë, akti administrativ objekt gjykimi duhet të shfuqizohet si një akt administrativ i pavlefshëm.

Edhe proçedura e zhvillimit të këtij gjykimi në shkallë të parë, rezulton të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 49/2012 dhe Kodit të Proçedurës Civile. Nuk konstatohen shkelje si në proçedurën e zhvillimit të gjykimit edhe në proçedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë. Për të gjitha sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur dhe personi i tretë dhe duke qënë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në analizë të plotë e të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit, referuar nenit 50, gërma "b" të ligjit nr. 49/2012, kjo Gjykatë vlerëson se duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, germa "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

**VENDOSI**

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 6404 (80-2015-4675), datë 17.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

-Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit

**Tiranë më 19.01.2018**

**ANËTAR**  
**Amarildo LAÇI**  
dv

**ANËTAR**  
**Bari SHYTI**  
dv

**KRYESUESE**  
**Lindita SINANAJ**  
dv

**Vertetohet njesia me origjinalin**

*Kancelari*  
*Leonard Stankaj*  
*Praktikant*